



**Tel: +355 4 22 69097**  
**+355 4 22 69325**  
**Fax:**  
**E-Mail: info@dpa.gov.al**

**Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i  
skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt  
standardeve**

**Kodi: DA-PM-008**

**Rishikim nr 5**  
**Dt: 10.09.2019**

**Faqe 1 nga 14**


**Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet  
drejt standardeve**

**Zbatues: Menaxheri i cilësisë, Drejtorët e departamenteve, Përgjegjësi i sektorit të personelit,  
Drejtori i Përgjithshëm, specialistët.**

**Përgjegjës për zbatim: Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit.**

Kontrolli: Menaxheri i Cilësisë  
Ardita MELE

Miratoi: Drejtori i Përgjithshëm  
Armond HALEBI

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</b></p>	<p><b>Kodi: DA-PM-008</b></p>
		<p><b>Rishikim nr 5</b>  <b>Dt: 10.09.2019</b></p>
		<p><b>Faqe 2 nga 14</b></p>

## 1 Qëllimi.

Procedura DA-PM-008 përcakton procedurën e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit për shtimin e aktiviteteve, vlerësimin e skemave të vlerësimit të konformitetit dhe menaxhimin e tranzicionit drejt standardeve/dokumentave të reja. Afati i akreditimit mund të zgjatet kur ka kërkesa të reja dhe kur kërkesat e akreditimit ndryshohen. Procedura synon të lehtësojë një qasje të harmonizuar brenda DPA, organizatave të akreditimit, pronarëve të skemave të vlerësimit të konformitetit dhe palëve të interesuara.

## 2 Fusha e zbatimit.

Procedura DA-PM-008 rregullon zgjerimin e fushëveprimit të akreditimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (në tekstin e mëposhtëm: DPA) gjatë shtimit të aktivitetit të ri të akreditimit dhe skemës së vlerësimit të konformitetit (në tekstin e mëposhtëm: SVK). Rregullat aktuale të procedurës gjithashtu përmbajnë hapat dhe veprimet që duhen bërë kur ndryshohen kërkesat që shërbejnë si bazë e akreditimit (kalimi në standarde). Gjithashtu kjo procedurë mund të zbatohet nga organet që aplikojnë për akreditim, organet e akredituara si edhe nga pronarët e skemave (në tekstin e mëposhtëm: PS)/ menaxherët e skemës që dëshirojnë të përdorin organe të akredituara të vlerësimit të konformitetit për të kryer aktivitetet e vlerësimit të konformitetit.


## 3 Përgjegjësitë.

Kjo procedurë zbatohet nga Përgjegjësi i sektorit të personelit dhe burimeve financiare, Drejtorët e departamenteve, Drejtori i Përgjithshëm, specialistët dhe Menaxheri i Cilësisë. Është përgjegjësi e Drejtorit të Zhvillimit, zbatimi i kësaj procedure.

## 4 Referimet.

Kjo procedurë referohet:

- Standardeve S SH ISO 17011, SSH ISO 19011,
- Politikës së DPA mbi zgjerimin e aktivitetit DA-PO-004,
- Ligjit Nr. 116, datë 11.09.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”,
- Manualit të cilësisë të DPA,
- Procedurës DA-PT-001 “Procedura e akreditimit, mbikqyrjes dhe rinovimit”,
- Politikës së Vlerësimit DA-PO-002,
- Politika e nënkontraktimit të vlerësimit DA-PO-006.
- DA-FO-079 Formulari i aplikimit për skemën e vlerësimit të konformitetit
- DA-FO-080 Lista kontrolluese për vlerësimin e një skeme të vlerësimit të konformitetit
- Procedura EA-1/22 A:2016 “EA Procedure and Criteria for the Evaluation of Conformity Assessment Schemes by EA Accreditation Body Members”.

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</b></p>	<p><b>Kodi: DA-PM-008</b></p>
		<p><b>Rishikim nr 5</b>  <b>Dt: 10.09.2019</b></p>
		<p><b>Faqe 3 nga 14</b></p>

## 5 Përkufizime.

Përkufizimet që janë subjekt i kësaj procedure janë të publikuara në Standardin ISO 17011.

**Veprimtaria e akreditimit**- Skema të Akreditimit

### Pronari i skemës (PS)

PS është një organizatë e identifikuar e cila ka zhvilluar SVK (skema e vlerësimit të konformitetit) dhe është përgjegjëse për planifikimin dhe përmirësimin e skemës.

Shembuj për pronarët potenciale të skemave:

- a) Organizmi i standardizimit,
- b) Organet e Vlerësimit të Konformitetit - (OVK)
- c) Organizatat që përdorin shërbimet e ofruara nga OVK,
- d) Organizatat që blejnë ose shesin aktivitetet e vlerësimit të konformitetit;
- e) Prodhuesit ose shoqatat që kanë zhvilluar skemën e tyre të vlerësimit të konformitetit


### Skema e Vlerësimit të Konformitetit (SVK)

Skema e vlerësimit të konformitetit është një dokument i cili përmban kërkesa të arritshme për publikun si edhe duhet të përmbajë komponentët e mëposhtëm:

- a) Subjektin e vlerësimit të konformitetit, p.sh., produkti, procesi, shërbimet, sistemi, personeli,
- b) kërkesat për vlerësimin e konformitetit,
- c) metodën në bazë të së cilës konformiteti është përcaktuar, p.sh. testimi, inspektimi ose çdo veprimtari që siguron konformitetin,
- d) çfarëdo kërkesë të përcaktuar nga PS ndaj OVK dhe çdo kërkesë e veçantë ose interpretim /shpjegim, nëse është e aplikueshme,
- e) cdo aplikim i veçantë ose interpretim / shpjegim të ISO / IEC 17011, nëse është e aplikueshme.

### Kërkesat specifike të skemës për organizmat e akreditimit

Aplikime shtesë të çdo kërkesë të standardit ISO/IEC 17011 për një skemë të vlerësimit të konformitetit të vendosur nga PS (p.sh. kriteret e veçanta të kompetencës për vlerësuesin, kriteret e vlerësimit, detajet e veçanta në raportin e vlerësimit etj.). Ato nuk duhet të jenë në kundërshtim me ose nuk përjashtojnë kërkesat e përmbajtura në standardin ISO/IEC 17011, Rregulloren e BE-së Nr. 765/2008 dhe dokumentet e detyrueshme të EA / ILAC / IAF. Vendimi përfundimtar për miratimin e këtyre kërkesave do të bëhet në nivel kombëtar nga DPA, dhe në rastet kur janë të interesuara më shumë vende, nga Asambleja e Përgjithshme e EA.

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</b></p>	<p><b>Kodi: DA-PM-008</b></p>
		<p><b>Rishikim nr 5</b>  <b>Dt: 10.09.2019</b></p>
		<p><b>Faqe 4 nga 14</b></p>

### **Kërkesat specifike të skemës për OVK**

Kërkesa të veçanta për OVK të përcaktuara nga PS. Ato nuk mund të jenë kontradiktore me njëra-tjetrën dhe nuk mund të përjashtojnë kërkesat e përmbajtura në standardet e akreditimit.

### **Njohja e OVK nga PS**

Njohja nga PS do të thotë se PS pranon certifikatat dhe raportet e lëshuara nga OVK duke konfirmuar se rezultati i testit ose kalibrimit, produkti, procesi, shërbimi, sistemi ose personi është në përputhje me kërkesat e skemës së vlerësimit të konformitetit. Si rezultat, OVK është në gjendje të kryejë aktivitetin e vlerësimit të konformitetit të mbuluar nga SVK ose mund të ketë të drejtën të përdorë markën e PS.

### **Vetëvlerësimi i OVK**


Vlerësimi i përputhshmërisë së OVK me kërkesat e akreditimit nga PS ose nga OVK.

## **6 Përshkrimi i procedurës.**

Zgjerimi i aktivitetit të DPA-së apo zgjerimi i fushës së akreditimit me aktivitetet e reja të akreditimit po merr një rëndësi të madhe duke bërë të mundur që DPA të mbështesë futjen e cdo kërkesë e cila është pranuar nga ekonomia ose palët e tjera të interesuara. Duke shtuar aktivitete të reja të akreditimit dhe skema vlerësimi konformiteti DPA ka për qëllim të forcojë besimin në akreditim për publikun e gjerë.

Në lidhje me këtë, DPA përcakton aspektet e mëposhtme:

1. DPA në thelb akrediton organet e vlerësimit të konformitetit sipas standardeve të harmonizuara. DPA ofron aktivitet të ri akreditimi, për të cilin është zhvilluar një standard i përshtatshëm i harmonizuar, në programin e aktivitetit të akreditimit të DPA-së.
2. DPA nis një aktivitet të ri akreditimi ose skemë të vlerësimit të konformitetit vetëm nëse kërkesa dhe nevoja për skemën ose veprimtarinë është e justifikuar dhe e siguar.
3. DPA mbështet standardizimin duke nisur një aktivitet të ri akreditimi ose skemë vlerësimi të konformitetit për të siguruar përfshirjen e palëve të interesuara në masën më të madhe të mundshme.
4. Deri në momentin e vendosjes për fillimin e një aktiviteti të ri akreditimi ose skemë të vlerësimit të konformitetit, DPA duhet vazhdojë aktivitetin në mënyrë të paanshme dhe pa u ndikuar.
5. Me qëllim lehtësimin e lëvizjes së lirë të mallrave brenda BE dhe në botë, DPA mbështet nisjen e skemave të reja kombëtare ose ndërkombëtare të vlerësimit të konformitetit.
6. DPA vlerëson dhe prezanton këto aktivitete të reja të akreditimit dhe skemat e vlerësimit të konformitetit në mënyrë transparente dhe efektive.
7. DPA fillon aktivitetin e ri të akreditimit ose skemën e vlerësimit të konformitetit, përkatësisht zgjerimin e fushës së akreditimit, në bazë të shkëmbimit të informacionit me organet e tjera evropiane të akreditimit dhe EA, dhe sipas rregullave të EA të zbatueshme.
8. DPA realizon veprimtarinë në përputhje me kërkesat e aplikueshme të standardit ISO / IEC 17011.

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</b></p>	<p><b>Kodi: DA-PM-008</b></p> <hr/> <p><b>Rishikim nr 5</b>  <b>Dt: 10.09.2019</b></p> <hr/> <p><b>Faqe 5 nga 14</b></p>
---	--	--

Nevoja për të nisur një aktivitet të ri akreditimi ose skemë vlerësimi të konformitetit mund të lindë në rastet kur:

1. Aktet ligjore (kombëtare dhe /ose evropiane), kërkojnë status të akredituar për një veprimtari që nuk e ka patur te nevojshem akreditimin me perpara,
2. Futja e një standardi të ri të vlerësimit të konformitetit (p.sh: ISO 14065, ISO 45001, EN ISO 17034),
3. Në fushat specifike të ekspertizës, aktiviteti i vlerësimit të konformitetit është specifikuar në standardet (p.sh. ISO 50001, EN 9104, ISO/TS 22003),
4. Nevoja për të shtuar një skemë të re të vlerësimit të konformitetit në emër të pronarëve të programeve / skemave për akreditim,
5. Futja e skemave të reja të vlerësimit të konformitetit nga organet e vlerësimit të konformitetit (si psh organet e certifikimit të produktit etj.).

## **7 Identifikimi i aktivitetit të ri.**

Identifikimi i aktivitetit të ri mund të vij nga:


- a) legjisllacioni
- b) standarde dhe dokumenta të reja
- c) aplikimi nga OVK

Identifikimi i aktivitetit të ri nga legjisllacioni dhe nga standardet dhe dokumentat e reja do të kryhet nga Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit.

Identifikimi i aktivitetit të ri nga aplikimet e OVK do të kryhet nga Drejtori i Drejtorisë e Akreditimit. Me identifikimin, Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit njofton Drejtorin e Përgjithshëm dhe Drejtorin e Drejtorisë së Zhvillimit.

Me identifikimin e aktivitetit të ri, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit, brenda pesë ditësh bën një analizë të nevojës së tregut për aktivitetin e ri dhe për llojin e vlerësimit të konformitetit, të cilën ja paraqet Drejtorit të Përgjithshëm. Është Drejtori i Përgjithshëm i cili vendos nëse DPA do të përfshihet në këtë aktivitet të ri ose jo. Nëse Drejtori i Përgjithshëm vendos mosfillimin e përgatitjes për aktivitetin e ri atëherë lajmërohet aplikuesi ose të interesuarit. Nëse Drejtori i Përgjithshëm vendos fillimin e përgatitjeve për ofrimin e aktivitetit të ri, Drejtori i Departamentit të Zhvillimit, brenda pesë ditësh nga marrja e vendimit krijon një grup pune të përbërë të paktën nga Menaxheri i cilësisë, Drejtorët e departamenteve dhe Përgjegjësi i sektorit të personelit dhe burimeve financiare për shqyrtimin dhe analizimin e burimeve për të filluar një aktivitet të ri të DPA. Në grupin e punës mund të përfshihen edhe specialistë të DPA ose persona kompetent jashtë saj.

Drejtori i Përgjithshëm mund të vendos edhe nënkontraktimin e vlerësimit sipas politikës DA-PO-006. Në këtë rast kryhet analiza e burimeve për personat e përfshirë në vendimarrje.

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</b></p>	<p><b>Kodi: DA-PM-008</b></p>
		<p><b>Rishikim nr 5</b>  <b>Dt: 10.09.2019</b></p>
		<p><b>Faqe 6 nga 14</b></p>

## 8. Analiza e burimeve

Grupi i punës brenda një periudhe jo më shumë se një muaj kryen analizën e burimeve të mëposhtme:

### 8.1 Analiza e vlerësimit të konformitetit

Grupi i punës vlerëson llojin e vlerësimit të konformitetit dhe përcakton nivelin e standardeve sipas klasifikimit të EA 1/06. Grupi i punës mund të përcaktojë edhe metodat apo standardet për kryerjen e vlerësimit të konformitetit.

### 8.2 Analiza e burimeve njerëzore.

Grupi i punës menjëherë me njohjen e kërkesës për aplikim, përcakton nevojën për burime njerëzore në fushën e kërkuar për akreditim. Për këtë arsye ai:

- Analizon e kompetencën e DPA, nëse mund të zbatohet zgjerimi i aktivitetit të akreditimit, duke marrë parasysh burimet egzistuese pëer shqyrtimin e aplikimit dhe marrjen e vendimit
- Vlerëson dhe pranon ekspertizë nga burime të tjera të jashtme (ekspertë, vlerësues teknik, komitete teknike dhe bordi i akreditimit),
- Studion shkallën e trajnimit të stafit në këtë fushë si dhe mundësitë dhe nevojat për vlerësues teknik nga lista e vlerësuesve të DPA,
- Shikon mundësitë për trajnimin e stafit dhe vlerësuesve teknik jashtë vendit si dhe organizimin e trajnimeve të brendshme duke përdorur lektorë nga stafi i brendshëm ose lektorë të jashtëm nga vendi ose të huaj.
- Merr anëtarë të rinj për grupet teknike të punës (nëse është e nevojshme) për veprimtarinë e re të akreditimit.


Kur burimet njerëzore nuk janë të mjaftueshme, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit kërkon vlerësues për fushën përkatëse brenda vendit. Informacioni për kërkimin e vlerësuesve të rinj, kriteret që duhet të plotësojnë i shpërndahet institucioneve të ndryshme shkencore, organeve të akredituar, komiteteve teknike, bordit të akreditimit, etj. Informacioni për vlerësues të rinj jepet edhe në Website-in e DPA. Përzgjedhja e kandidaturave për vlerësues kryhet sipas procedurës DA-PM-002.

Nëse nuk gjenden vlerësues vendas, atëherë zbatohet politika DA-PO-003, paragrafi 4.3 për gjetjen e vlerësuesve të huaj.

Nëse nuk sigurohet kompetenca e marrësve të vendimit, atëherë kërkohet rekomandimi nga grupi teknik përkatës.

### 8.3 Hartimi i procedurave dhe përfshirja në dokumentat e sistemit të menaxhimit.

Grupi i punës vlerëson nevojën për dokumente zbatimi ose udhëzime. Sipas nevojës DPA adopton dokumente zbatimi ose udhëzime dhe /ose merr pjesë në përgatitjen e tyre. Grupi i punës sigurohet më parë që dokumente të tilla janë formuluar nga komitetet ose personat që zotërojnë kompetencën e nevojshme dhe përfshirjen e palëve të interesuara. DPA përdor dokumente zbatimi ose udhëzues ndërkombëtarë në rastet kur ato janë të disponueshme.

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</b></p>	<p><b>Kodi: DA-PM-008</b></p>
		<p><b>Rishikim nr 5</b>  <b>Dt: 10.09.2019</b></p>
		<p><b>Faqe 7 nga 14</b></p>

Gjithashtu DPA përdor udhëzues kombëtar ose ndërkombëtar për operimin e OVK. Kriteret për vlerësimin e OVK jepen në ``Politikën e Vlerësimit`` DA-PO-002, pika 3.

Grupi i punës harton procedurat e nevojshme dhe pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm, Menaxheri i Cilësisë i përfshin ato në dokumentat e sistemit të menaxhimit.

#### **8.4 Analiza e burimeve financiare.**

Gjithashtu grupi i punës përcakton nevojat financiare lidhur me fushën e re të akreditimit në të cilin DPA dëshiron të zgjerojë aktivitetin e saj si dhe nëse është e nevojshme përcakton tarifa të reja.

#### **8.5 Vendimi për aktivitetin e ri.**

Pas kryerjes së analizës dhe sigurimit ose jo të plotësimit të kërkesave për ofrimin e një aktiviteti të ri Drejtori i Zhvillimit i propozon Drejtorit të Përgjithshëm:

- a) Fillimin e ofrimit të shërbimit të ri
  - b) Mos fillimin e ofrimit të shërbimit të ri
  - c) Nënkontraktimin e vlerësimit.
- a) Nëse vendimi është fillimi i ofrimit të shërbimit, atëherë, Drejtoria e Akreditimit bazuar në burimet e siguruar ndjek procedurën e akreditimit sipas DA-PT-001. Drejtoria e Zhvillimit publikon në faqen zyrtare të DPA fillimin e ofrimit të shërbimit dhe kërkesat në lidhje me të.
  - b) Nëse vendimi është mosfillimi i ofrimit të shërbimit, DPA njofton klientin ose palët e interesuara për arsyet e mosfillimit të këtij aktiviteti.
  - c) Nëse Drejtori i Përgjithshëm vendos nënkontraktimin e vlerësimit, atëherë zbatohet politika DA-PO-006. Në këtë rast duhet të jetë e siguruar kompetenca e personave të përfshirë në vendimarrje.


### **9 Shtimi i një skeme të re të vlerësimit të konformitetit.**

Me paraqitjen e kërkesës për aplikimin e një skeme të re të vlerësimit të konformitetit sipas formës DA-FO-79 "Formulari i aplikimit për skemën e vlerësimit të konformitetit", DPA do të realizojë vlerësimin e skemes sipas formës DA-FO-080 "Lista kontrolluese për vlerësimin e një skeme të vlerësimit të konformitetit",

SVK-të e reja të krijuara nga ligjvënësi pasi të vlerësohen nga DPA, do të përfshihen në aktivitetet e saj të akreditimit.

SVK-të e reja që janë të vlerësuara nga EA, IAF, ILAC ose ndonjë organizem tjetër akreditues (MLA), nuk do të vlerësohen përsëri nga DPA, por DPA do të njohë rezultatet e vlerësimit të kryer dhe vendos për shtimin e saj.

Skemat e reja të vlerësimit të konformitetit të bëra nga shoqatat, organet e certifikimit, prodhuesit ose grupet e tjera të interesit, skemat e vlerësimit të konformitetit të ashtuquajtur "interesa private", do të shqyrtohen nga DPA nëse ato mund të shtohen në akreditim. Organi duhet të aplikojë për shtimin e skemës së

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</b></p>	<p><b>Kodi: DA-PM-008</b></p>
		<p><b>Rishikim nr 5</b>  <b>Dt: 10.09.2019</b></p>
		<p><b>Faqe 8 nga 14</b></p>

vlerësimin të konformitetit të "interesit privat". DPA duhet të tërheq vëmendjen e pronarëve të skemës së vlerësimin të konformitetit në kërkesat e procedurës EA-1/22 A:2016.

Kërkesat e reja të palëve të interesuara në akreditim mund të ndodhin në mënyrat e mëposhtme për futjen e një SVK të re:

- a) Ligjet e reja janë paraqitur nga autoritetet e qeverisë në fushën e rregulluar ligjërisht në lidhje me miratimin e produkteve (duke përfshirë shërbimet) në fushat e sigurisë, mbrojtjes së shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe për të parandaluar mashtrimet dhe për të siguruar drejtësinë e konkurrencës në treg;
- b) Kërkesa që vijnë nga tregu të cilat nuk janë të rregulluara ligjërisht, ku disa industri mund të paraqesin - pjesërisht brenda njësive ekonomike të caktuara dhe pjesërisht brenda të gjithë sektorit - vlerësimet e konformitetit dhe skemat e miratimit që synojnë në arritjen e një standardi minimal teknik, në të njëjtat kushte konkurrence.


Kërkesat e aplikueshme për skemat e vlerësimin të konformitetit bazohen në standardet e akreditimit dhe në udhëzimet e zbatueshme të EA, IAF dhe ILAC si edhe në Procedurat e DPA. Procedura EA-1/22 A:2016 jep udhëzime për skemat e vlerësimin të konformitetit. Në përgjithësi rekomandohet që pronarët e skemës duhet të përdorin udhëzimet në dokumentet e instrumenteve të vlerësimin të konformitetit ISO / CASCO gjatë planifikimit të skemës së vlerësimin të konformitetit.

### **9.1 Procesi i shtimit të një skeme të re të vlerësimin të konformitetit.**

Shtimi i skemës së re të vlerësimin të konformitetit kryhet si më poshtë:

1. Aplikimi nga pronari i skemës për vlerësimin e skemës së re të vlerësimin të konformitetit për akreditim sipas forms DA-FO-079.
  2. Aplikuesi duhet t'i ofrojë DPA-së të gjitha informatat dhe dokumentet e nevojshme për vlerësimin e skemës së re sipas DA-FO-080.
  3. Informacioni që duhet të sigurohet nga pronarët e skemave duhet të dorëzohet në përputhje me kërkesat e procedurës EA-1/22 A:2016.
  4. Kushtet dhe kërkesat për pronarët e skemës janë të përfshira në procedurën EA-1/22 A:2016.
  5. DPA mund të përfshijë grupet teknike të punës, Bordin e Akreditimi, autoritetet qeveritare dhe palët e tjera të interesuara në analizën dhe vlerësimin e skemës.
  6. DPA duhet të zhvillojë konsultime me përfaqësuesit e palëve të interesuara para pranimit të kërkesës.
  7. DPA shqyrton nëse burimet njerëzore (vt,et,vs) janë në dispozicion.
  8. Dokumentacioni për skemën e re të vlerësimin të konformitetit kalon për shqyrtim te Bordi i Akreditimit i cili në fund të mbledhjes do të dali me sugjerimet përkatëse.
- Vendimin përfundimtar për pranimin e skemës së re të vlerësimin të konformitetit merret nga Drejtori i Përgjithshëm i DPA.
9. Njoftimi i aplikantit për vendimin dhe publikimin e vendimit do të realizohet në ëëëbsite e DPA-së.



 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</b></p>	<p><b>Kodi: DA-PM-008</b></p>
		<p><b>Rishikim nr 5</b>  <b>Dt: 10.09.2019</b></p>
		<p><b>Faqe 9 nga 14</b></p>

10. Nëse është e nevojshme, DPA duhet të bashkëpunojë edhe me grupet teknike të punës për të zhvilluar rregullat dhe kërkesat e aplikueshme të teknologjisë dhe akreditimit në mënyrë uniforme.
11. Nëse është e nevojshme, DPA duhet të bashkëpunojë edhe me organet kombëtare dhe / ose ndërkombëtare në lidhje me misionin e skemës së re.
12. DPA merr masa për zgjerimin e grupit të vlerësimit me ekspertë, vlerësues sipas skemës së re.
13. Trajnimi i punonjësve të DPA dhe vlerësuesve të jashtëm të DPA.
14. DPA duhet të marrë masa për përfshirjen e anëtarëve të rinj në grupet teknike të punës dhe në Bordin e Akreditimit.
15. Shtimi i skemës së re në mesin e aktiviteteve të akreditimit të DPA-së.
16. DPA-ja mban rregjistrime për palët e interesuara në SVK-të e ndryshme dhe ndryshimet e tyre.

Kur për shkak të ndryshimeve në legjislacion ose mungesës së interesit të tregut, DPA vendos për pezullimin ose përfundimin e akreditimit sipas një SVK të caktuar, dhe për këtë do të:

- a) të kërkojë mendimin e palëve të interesuara,
  - b) të shqyrtojë përmbushjen e kontratave me PS (ndërprerjen),
  - c) informon palët e interesuara në një komunikatë në faqen e saj zyrtare,
  - d) të ndjekë komunikimin e jashtëm,
  - e) japë deklaratë për vlefshmërinë e akreditimeve të lëshuara,
  - f) nëse paraqitet një SVK e re për të zëvendësuar të mëparshmet, publikohen rregullat e tranzicionit.
- DPA duhet të hartojë procesverbal mbi konsultimin dhe rezultatet e tij me palët e interesuara.

## 9.2 Kërkesat e aplikueshme për SVK


### 9.2.1 Kompetenca dhe paanshmëria

- a) Çdo SVK do të përpilohet nga persona të cilët demonstronjë se janë në gjendje të kryejnë këtë detyrë.
- b) Kjo kompetencë përfshin njohjen e fushës teknike si dhe të procedurës së vlerësimit të konformitetit.
- c) Të përcaktohen kompetencat e kërkuara për personat që kryejnë veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit të një SVK.

### 9.2.2 Përkrahja e tregut

Duhet të sigurohen dëshmi për pranimin e skemës nga tregu. PS duhet të jetë në gjendje të paraqesë dëshmitë e mbështetjes së tregut të SVK-së të marra nga palët përkatëse të interesuara - veçanërisht nga përdoruesit e fundit (p.sh., konsumatorët dhe industria). Me palët e interesuara duhet të zhvillohen konsultime dhe duhet të sigurohen dëshmitë e këtij konsultimi.

### 9.2.3 Vlefshmëria e SVK.

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</b></p>	<p><b>Kodi: DA-PM-008</b></p>
		<p><b>Rishikim nr 5</b>  <b>Dt: 10.09.2019</b></p>
		<p><b>Faqe 10 nga 14</b></p>

Pronari i skemës duhet të vërtetojë vlefshmërinë e SVK-së para dorëzimit tek DPA. Një kërkesë për vlefshmërinë e skemës është se skema duhet të ketë një periudhë auditimi të suksesshme që tregon se skema mund të zbatohet dhe është në harmoni me qëllimet dhe pritjet e pronarëve të skemës. Dokumenti për vlerësimin e një SVK-je duhet të përmbajë:

- a) përshkrimin e objektivit të skemës;
- b) përshkrimin e kërkesave të skemës;
- c) analizën e përputhmërisë së kërkesave të përcaktuara për përmbushjen e objektivave të përcaktuar të skemës;
- d) përshkrimin e metodave që do të zbatohen në përcaktimin e përmbushjes së detyrimeve;
- e) vendimin për veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit (duke përfshirë edhe identifikimin e standardit të vlerësimit të konformitetit që duhet të zbatohet);
- f) analizën e përshtatshmërisë së aktivitetit të përzgjedhur të vlerësimit të konformitetit.

#### **9.2.4 Vlerësimi i skemave të vlerësimit të konformitetit.**

Për vlerësimin e skemave të vlerësimit të konformitetit mund të ndiqen dy opsione:

1. Skema është në pronësi të një organi i cili ka aplikuar për t'u akredituar ose të një organi të akredituar (ovk),
2. Skema është në pronësi të një organizate (pronari i skemës) i cili aplikon për pranimin e skemës së saj.

##### ***Opsioni 1: Skemat në pronësi të OVK.***


Skema vlerësohet nga DPA në vlerësimin fillestar ose në zgjerimin e fushës së akredituar. Para se të kryhet një vlerësim i tillë, i cili në shumicën e kohës përfshin edhe dëshmitë e aktivitetit të vlerësimit të konformitetit, aplikanti duhet të dorëzojë aplikimin DA-FO-079 dhe DA-FO-080 së bashku me dokumentacionin e skemës.

Theksojme se procedura EA 1/22 nuk është e detyrueshme për tu zbatuar nëse pronari i skemës është një ovk që kërkon akreditim për një svk të cilën e ka për përdorim të brendshëm. Megjithatë edhe në këto raste rekomandohet që vlerësimi i svk-ve të tilla të ndjekë procesin e përshkruar në Annex 1 të procedurës EA 1/22.

##### ***Opsioni 2: Aplikimi i dorëzuar nga PS për pranimin e skemës.***

PS mund të paraqesë një kërkesë për pranimin e SVK-së së tyre. Vlerësimi i një skeme të përgatitur nga një PS përbëhet nga hapat e mëposhtëm:

1. Pronari i skemës dërgon dokumentacionin e skemës (ketu përfshihen format DA-FO-079 dhe DA-FO-080) tek DPA
2. Të paktën një OVK ka kërkuar nga DPA që të akreditohet sipas kërkesave të SVK-së.
3. Më pas, DPA shqyrton kërkesën për vlerësimin e skemës, përcakton dhe përgatit vlerësimin e kostos që duhet të dorëzohet në PS.

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</b></p>	<p><b>Kodi: DA-PM-008</b></p> <hr/> <p><b>Rishikim nr 5</b>  <b>Dt: 10.09.2019</b></p> <hr/> <p><b>Faqe 11 nga 14</b></p>
---	--	---

4. Pas miratimit të buxhetit përkatës, DPA kryen vlerësimin dhe i dërgon rezultatet e tij në PS (aplikantit). Pas zgjidhjes së moskonformiteteve, mund të merret një vendim pozitiv për miratimin e skemës. Bazuar në SVK, akreditimi i OVK mund të vazhdojë.

5. Në vlerësimin e OVK për një akreditim të ri, mund të ndodhin mospërputhje në lidhje me SVK-në, të cilat janë lënë pa u vënë re në vlerësimin fillestar të SVK-së. Mospërputhjet e identifikuar në aktivitetin e vëzhguar korrigjohen nga OVK, të cilat pritet të jenë në përputhje me nevojat e PS.

### **9.3 Bashkëpunimi me EA dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë të akreditimit.**

DPA vlerëson dhe vendos për shtimin e skemave të vlerësimit të konformitetit të aplikimit vetëm kombëtar (të brendshëm) në aktivitetet e akreditimit. Në rastin kur kemi skema të tilla, DPA nuk përfshin EA ose organizma të tjera akredituese.

Në rast të skemave të aplikuara ndërkombëtarisht, DPA identifikon organin kombëtar të akreditimit, të ashtuquajturin "trupi akreditues shtëpi", i cili ka kryer vlerësimin e parë dhe ka monitoruar ndryshimet e mundshme të skemës. Vetëm organizmi i akreditimit bashkëpunon me pronarin e skemës.

Bashkëpunimi i DPA me EA kryhet sipas procedurës EA-1/22 A:2016. Procedura EA-1/22 A:2016 përshkruan kërkesa të mëtejshme për shtrirjen në nivel ndërkombëtar dhe njohjen reciproke për PS.

### **9.4 Ndryshimet në kërkesat e akreditimit.**

Në rast se kërkesat e akreditimit ndryshojnë, DPA ndjek gjithmonë udhëzimet e organizatave ndërkombëtare.

Në bazë të udhëzimeve të organizatave ndërkombëtare, DPA përgatit planin për periudhën e tranzicionit për futjen e sistemit të kërkesave të modifikuara. Plani përmban detyrat e DPA dhe të organeve të akredituara, duke specifikuar gjithashtu afatet.

#### **9.4.1. Detyrat e DPA për periudhën e tranzicionit.**


Në bazë të kërkesave të modifikuara dhe udhëzimeve ndërkombëtare DPA përcakton hapat dhe afatet për organet e akredituara, për të siguruar kohë për përgatitjen e sigurt dhe vlerësimin e përmbushjes së kërkesave.

DPA informon organet e akredituara dhe aplikantët rreth ndryshimeve të kërkesave në faqen e saj të internetit.

DPA i bën thirrje organeve të akredituara me anë të një komunikimi se ato duhet të përgatisin dhe dorëzojnë planet e tyre për periudhën e tranzicionit brenda afatit të caktuar.

DPA organizon kurset e trajnimit të nevojshme për përgatitjen e duhur të stafit të brendshëm dhe vlerësuesve të jashtëm.

DPA pasi vlerëson dhe mbledh planet e tranzicionit, përgatit planin e saj të tranzicionit si pjesë e planit të auditimit.

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve</b></p>	<p><b>Kodi: DA-PM-008</b></p>
		<p><b>Rishikim nr 5</b>  <b>Dt: 10.09.2019</b></p>
		<p><b>Faqe 12 nga 14</b></p>

Në rast se kërkesat ndryshohen, organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit përcaktojnë një periudhë tranzicioni. Pas skadimit të periudhës së tranzicionit, akreditimi për organet e akredituara që nuk i përmbushin kërkesat e reja revokohet nga DPA, ose revokimi mund të kërkohej vullnetarisht.

Gjatë periudhës së tranzicionit, organi i akredituar do të marrë parasysh datën e lëshimit të standardit përkatës kur përcakton datën e skadimit të certifikatave të dhëna sipas standardit përkatës. Prandaj, data e skadimit nuk mund të jetë më vonë se fundi i periudhës së tranzicionit dhe certifikatat e dhëna sipas standardeve të pavlefshme bëhen të pavlefshme.

DPA konfirmon konformitetin e aktivitetit të certifikimit të organeve të akredituara në kuadrin e procedurës së akreditimit dhe procedurës vjetore të mbikëqyrjes/ ose procedurës së mbikëqyrjes jashtëzakonshme. Organi i akredituar mund të lëshojë certifikim të ri sipas standardeve të reja vetëm pasi të kalojë tranzicionin në mënyrë të suksesshme.

#### 9.4.2. Detyrat e organeve të akredituara për periudhën e tranzicionit.

Në mënyrë që DPA të planifikojë programin e akreditimit të kalimit në standardin e ri, organet e akredituara duhet të dorëzojnë në sekretariatit e DPA-së planin për periudhën e tranzicionit, për kalimin në akreditim sipas standardeve të reja brenda afatit të përcaktuar nga DPA.

Gjatë përgatitjes së planit të tranzicionit, duhet të merren parasysh:

- a) trajnimi i stafit të brendshëm, auditorëve, vlerësimi i kompetencave;
- b) Informimi i klientëve ekzistues dhe të ardhshëm për periudhën dhe kërkesat e tranzicionit;
- c) rishikimi i planit të auditimit dhe certifikimit;
- d) rishikimin e periudhës së certifikimit dhe ciklit të tranzicionit;
- e) koha e nevojshme për marrjen e vendimeve të certifikimit për azhurnimin e certifikatave.

## 10 RREGJISTRIMET

Titulli i dokumentit	Kush e plotëson	Kur e plotëson	Kush e ruan
DA-FO-079	Aplikuesi	kur aplikon për vlerësimin e skemës së vlerësimit të konformitetit	Drejtori i Drejtorise se Zhvillimit
DA-FO-080	Grupi i punës	Në përfundim të vlerësimit të skemës	Drejtori i Drejtorise së Zhvillimit

## 11 HISTORIKU



**Tel: +355 4 22 69097**  
**+355 4 22 69325**  
**Fax:**  
**E-Mail: info@dpa.gov.al**

**Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i  
skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt  
standardeve**

**Kodi: DA-PM-008**

**Rishikim nr 5**  
**Dt: 10.09.2019**

**Faqe 13 nga 14**

<b>Data e ripunimit</b>	<b>Numri i rishikimit</b>	<b>Hartoi</b>	<b>Përshkrimi i ndryshimeve</b>
30.10.2006	0	Aleks Cuni	Versioni fillestar
30.10.2009	1	Ermira Fyshku Besnik Pani	Ndryshime në pikën 4 referimet, logo e DPA dhe ndreqja e gabimeve ortografike Është shtuar një paragraf në pikën 7.1.1 në lidhje me trajnimin e stafit
20.05.2010	2	Ermira Fyshku	Ndryshime në pikën 3 dhe 6.1.3 në lidhje me përgjegjësinë e drejtorit të zhvillimit. Ndryshime në pikën 7.1.1 në lidhje me paragrafin 4.6.3 të standardit ISO/IEC 17011 si dhe në pikën 7.2 në lidhje me paragrafin 4.6.2; 4.6.3 c të standardit ISO/IEC 17011
22.12.2014	3	Ermira Fyshku	Ndryshime në header dhe lidhur me legjislacionin e ri
20.05.2019	4	Suela Kromidha	Implementimi i stanadardit ISO/IEC 17011:2017
10.09.2019	5	Suela Kromidha	Ndryshime ne paragrafet 7, 8 dhe 9